



Në bazë të nenit 4.1 lidhur me nenin 7 të Rregullorës mbi Vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr.2000/45, nenit 88 lidhur me nenin 38 dhe 74 të Statutit të Komunës, Kuvendi Komunal i Vushtrrisë në seancën e vet të mbajtur më 01.07.2004 miraton këtë:

**RREGULLORE**  
**PËR ZBATIMIN E DISPOZITAVE TË RREGULLORES NR.2000/45 MBI**  
**VETËQEVERISJEN E KOMUNAVE TË KOSOVËS DHE STATUTIT TË**  
**KOMUNËS SË VUSHTRRISË PËR KONSULTIM DHE**  
**PJESËMARRJE TË PUBLIKUT NË VENDIMARRJE**  
**TË KUVENDIT DHE ORGANEVE TË TIJ**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Kuvendi Komunal miraton këtë rregullore me qëllim të zbatimit të dispozitave përkitazi me konsultimin dhe pjesëmarrjen e publikut, të parashtruara në Statutin e Komunës së Vushtrrisë dhe në Rregulloren e UNMIK-ut 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, si dhe me qëllim të garantimit të të drejtave të publikut për t'u informuar dhe për të marrë pjesë në punën e qeverisë së tij.

**Neni 2**

**Fushëveprimtaria**

Kjo rregullore ka të bëjë me mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve të tij të cilat janë të hapura për publikun, me njoftimin e publikut përkitazi me mbledhjet, me pjesëmarrjen e publikut gjatë mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve të tij, si dhe me informacionet e qeverisë që duhet t'i vihen në dispozicion publikut.

Rregullat dhe procedurat e tjera plotësuese mund të vendosen në rregullore të tjera.

**Neni 3**

**Mbledhjet e hapura të Kuvendit dhe të komiteteve të tij**

Konform Neni 7 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve të tij, në rrjedha normale janë të hapura për publikun, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e shtypit. Në rastet kur Kuvendi i Komunës, ose ndonjë komitet vendos në pajtim me nenin

7.3, 7.4 ose 7.5 që ndonjë mbledhje të mbyll për publikun, ai duhet të paraqes njoftim publik, si dhe të jep publikisht shpjegim lidhur me arsyen për një vendim të tillë. Ky njoftim publik duhet t'i vihet në dispozicion publikut së paku 3 (tre) ditë para mbledhjes së caktuar, si dhe duhet të jetë konform dispozitave të përcaktuara me nenin 3 të kësaj rregulloreje.

#### **Neni 4** **Njoftimi publik për takimet**

Ashtu siç kërkohet me Rregulloren 2000/45, njoftimin publik për mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve të tij duhet bërë së paku 7 (shtatë)ditë pune para mbledhjes, ose përjashtimisht 3 (tre) ditë në raste të jashtëzakonshme, ndërsa njoftimi publik për tubimet publike duhet bërë së paku 2 (dy) javë paraprakisht.

4.1. Njoftimi publik, për qëllime të kësaj rregulloreje:

4.1.1 do të thotë njoftimi me shkrim lidhur me vendin dhe datën, ndërsa kur bëhet fjalë për mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij, si dhe me tubimet publike, krahas rendit të ditës që i thekson çështjet që do të diskutohen, duhet bashkangjitur edhe kohën që do t'i kushtohet secilës pikë të rendit të ditës, si dhe një përshkrim të shkurtër, por domethënës të pikave të rendit të ditës;

4.1.2 lëshohet në mënyrën vijuese: duke e afishuar në tabelën e shpalljeve të vendosur në ndërtesën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke e emituar në radiostacione lokale dhe duke e postuar në faqen e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë në Internet;

4.1.3 përfshinë një proklamata që personat që nuk janë në gjendje të marrin pjesë në mbledhjen, apo tubimin publik të paralajmëruar, mund t'i parashtrojnë Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, deri në kohën kur të fillojnë punimet, komentet me shkrim lidhur me temën e mbledhjes, apo të tubimit publik. Komentet në fjalë do të futen në procesverbalin zyrtar dhe komentet e tilla do t'i vihen në vëmendje personit ose personave të cilëve duhet t'iu dorëzohen ato komente me shkrim.

4.2. Përshkrimi i një pike të rendit të ditës është domethënës nëse është mjaft i qartë dhe konkret për t'ia tërhequr vëmendjen një personi me intelekt dhe arsimim mesatar, interesat e të cilit preken nga pika e tillë. Në rast se pikat e rendit të ditës nuk mund të përshkruhen në tërësi në një faqe shkrimi, përshkrimi duhet të përmbajë informata lidhur me atë se ku mund t'i siguroj publiku informatat plotësuese përkitazi me pikat e rendit të ditës para mbajtjes së mbledhjes, apo të tubimit publik.

#### **Neni 5** **Pjesëmarrja e publikut në tubime dhe mbledhje**

5.1. **Tubimet publike.** Ashtu siç parashikohet në kapitullin 1 ninin 37 të Statutit, procedurat që duhet ndjekur në tubime publike i përcakton Kryetari ose përfaqësuesi i tij, ose i saj , i cili do të jetë kompetent për moslejimin e diskutimit të çështjeve që nuk përkojnë me përgjegjësitë, ose kompetencat e komunës, ose me drejtimin e punëve komunale; për kundërshtimin e dhënies së fjalës, ose për

të mos i dëgjuar fotësit që paraqesin pikëpamje të ngjashme, ose të përsëritura dhe për të vendosur kufizime të përgjithshme të kohës së lejuar për fjalime.

- 5.2. **Mbledhjet e Kuvendit të komunës dhe të komiteteve.** Për çdo rend të ditës të mbledhjes së Kuvendit të Komunës, ose të komiteteve të tij, publikut duhet t'i ofrohet mundësia që të bëjë vërejtje dhe të parashtror pyetje përkitazi me secilën pikë të rendit të ditës, para se Kuvendi të marrë çfarëdo vendimi lidhur me pikën përkatëse.
- 5.2.1. Një kufizim i arsyeshëm kohor do të caktohet për vërejtjet dhe pyetjet e publikut lidhur me secilën temë dhe se kufizimi i tillë do të figurojë edhe në rend të ditës. Kufizimi i arsyeshëm kohor do të përcaktohet duke u bëmshetur në natyrën rutinore ose kundërthënëse të temës; shkallën e interesimit të shprehur nga publiku për temën; ndikimin që vendimi do të ketë tek anëtarët e publikut, si dhe ngutshmërinë kohore të çështjes për t'u vendosur. Kohëzgjatja e përcaktuar për një pikë të rendit të ditës, sido që të jetë, nuk mund të jetë më pak se 5 minuta dhe jo më shumë se 1 orë.
- 5.2.2. Anëtarët e publikut të cilët dëshirojnë t'i drejtohen Kuvendit të Komunës, ose komiteteve të tij duhet t'i parashtror një kërkesë me shkrim Kryetarit ose Kryeshëfit të Ekzekutivit së paku 1 orë para mbledhjes duke potencuar temën për të cilën personi në fjalë dëshiron të flasë.
- 5.2.3. Kryetari, ose përfaqësuesi i tij, ose i saj i ftojnë anëtarët e publikut të cilët kanë parashtruar kërkesë me shkrim që t'i drejtohen Kuvendit të Komunës, ose komiteteve të tij dhe i lejon fjalimet e tyre gjatë dhe deri në kohën e përcaktuar në rend të ditës.
- 5.2.4. Kryetari mund të kufizojë kohën për çdo folës në 3 (tre) minuta. Kryetari mund të mos ftojë apo të dëgjojë folës ose mund t'ua kufizojë kohën për të folur më pak se 3 (tre) minuta atyre folësve që paraqesin pikëpamje të përsëritura, atyre që dëshirojnë të flasin për një temë që nuk figuron në rend të ditës, apo që nuk është duke u shqyrtuar aktualisht nga Kuvendi ose atyre që përmes fjalimit polemizues, shpifës ose iritues rrezikojnë që ta prishin mbledhjen.
- 5.2.5. Kohëzgjatja e përcaktuar në rend të ditës për vërejtje dhe pyetje të publikut mund të zgjatet nga Kryetari ose përfaqësuesi i tij, ose i saj. Përveç kësaj, ai ose ajo, sipas gjykimit të tij ose të saj, mund t'ua jap të drejtën për t'iu drejtuar Kuvendit ose komiteteve të tij individëve të cilët marrin pjesë në mbledhje e që Nuk kanë parashtruar kërkesë me shkrim:
- 5.2.5.1. në rast se publiku tregon interesimin e tij për temën duke (a) parashtruar kërkesa me shkrim për t'iu drejtuar Kuvendit para mbajtjes së mbledhjes ose (b) merr pjesë në mbledhjen e Kuvendit në atë numër që nënkupton interesimin e gjërë ose të ndieshëm dhe/ose huti për temën;
- 5.2.5.2. në rast se pikëpamjet e kundërta lidhur me temën nuk kanë pasur rast të dëgohen në mënyrë të barabartë.

## **Neni 6**

### **E drejta e publikut për t'u informuar**

- 6.1. **Shikimi i dokumenteve.** Në pajtim me Rregulloren nr.2000/45 të UNMIK -ut, neni 7, i cili përcakton të drejtën e çdo personi që t'i shikojë dokumentet që mbahen nga komuna varësisht nga disa kufizime të caktuara, Qeveria Komunale do të nxjerr rregulla dhe do të përcaktojë procedurën dhe mundësitë për pranimin dhe përpunimin e kërkesave për dokumente si dhe për shumëzimin dhe sigurimin e atyre dokumenteve me kohë.
  - 6.1.1. Qeveria Komunale do t'i përgjigjet kërkesës për shikim të dokumenteve me kohë dhe në mënyrë efikase dhe sido që të jetë, brenda 20 ditëve nga paraqitja e kërkesës.
  - 6.1.2. Nëse ndonjë anëtar i publikut i refuzohet shikimi i ndonjë dokumenti në pajtim me Rregulloren nr.2000/45 të UNMIK -ut, neni 7.3 ose për ndonjë arsye tjetër, personit që e ka bërë kërkesën duhet t'i paraqitet me shkrim arsyeja konkrete për refuzimin e tillë. Personi në fjalë ka të drejtë që të ushtrojë ankesë kundër refuzimit tek Kryeshefi i Ekzekutivit i cili e miraton ose e hedh poshtë ankesën në fjalë brenda 20 ditësh.
  - 6.1.3. Nëse, për shkak të veçantisë së kërkesës ose të nevojës për konsultim me një palë të tretë, Qeveria Komunale nuk mund ta sigurojë dokumentin e kërkuar brenda 20 ditësh, ajo duhet ta njoftojë me shkrim palën e interesuar jo më vonë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës duke shpejguar pamundësinë e përmbushjes së kërkesës për informim brenda afatit kohor prej 20 ditësh, duke i potencuar arsyet ose shkaqet e vonës, gjithashtu dhe datën e sigurtë se kur do të sigurohen dokumentet ose informatat.
  - 6.1.4. Qeveria Komunale e publikon një shpallje duke potencuar të drejtën e publikut që të shikoj dhe/ose të siguroj kopje të dokumenteve si dhe procedurën që duhet ndjekur një anëtarë i publikut që kërkon ndonjë dokument. Shpallja përfshin vendet dhe personat të cilëve u paraqiten kërkesat, ditët dhe orët kur pranohen kërkesat, formularët eventuale që duhet plotësuar për paraqitjen e kërkesës, të dhënat e nevojshme për gjetjen e dokumenteve që kërkohen dhe afatet kohore gjatë të cilave do të kthehen përgjigjet. Publikimi, për qëllime të kësaj dispozite, nënkupton afishimin e informatave në tabelën e shpalljeve të vendosur në ndërtesën e Kuvendit të Komunës së Vushtrisë, në faqen e Qeverisë Komunale në internet dhe në mediat lokale.
- 6.2. **Informacionet e Qeverisë Komunale në dispozicion për publikun.** Qeveria Komunale, brenda 3 (tre) muajsh nga data kur kjo rregullore hyn në fuqi, duhet ta Publikojë një shpallje duke shënuar drejtoratet, departamentet, komitetet, sektorët dhe zyrat e qeverisë; detyrat e tyre përkatëse; emrin e personit përgjegjës për punën e tyre; lokacionet, ditët dhe orarin e punës; terminet e caktuara gjatë të cilave publiku mund të kryej punë në drejtorate dhe emrin dhe shënimet kontaktuese të personit të ngarkuar me nenin 69 dhe 74 për ofrimin e informatave publike. Kjo shpallje duhet të plotësohet dhe të ripublikohet çdo gjashtë muaj.

Publikimi, për qëllime të këtij neni, nënkupton afishimin e informatave në tabelën e shpalljeve të vendosur në ndërtesën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, në faqen e Qeverisë Komunale në internet, duke e emituar në radiostacione lokale dhe media të tjera ekzistuese lokale.

- 6.3. Secili drejtor drejtorati i Kuvendit të Komunës duhet ta ngarkojë një person ose disa persona të njohur me punët e drejtoratit të cilët do të jenë përgjegjës për ofrimin e informatave me gojë dhe me shkrim me kërkesë të publikut përkitazi me ecurinë e punës, planet, politikat dhe qëndrimet e drejtoratit. Personi i ngarkuar asisoj duhet të jetë i përgatitur që të ofrojë, me kërkesë, informata të caktuara gojore dhe me shkrim përkitazi me (a) rregullat, procedurat dhe mënyrat me anë të së cilave publiku mund të kryej punë në drejtorat; (b) politikat e përgjithshme dhe rregullat ligjore me anë të së cilave vepron drejtorati; dhe © shpjegimet e hollësishme të mënyrës së punës dhe të procedurave të këtij organi publik.
- 6.4. Qeveria komunale duhet që brenda 3 (tre) muajsh nga data kur kjo rregullore hun në fuqi, ta publikojë një deklaratë të të drejtave të publikut të cilat parashikohen në këtë rregullore: të drejtën për 7 (shtatë) ditë njoftim paraprak për mbledhjet e Kuvendit dhe të komiteteve të tij, duke përfshirë edhe rendin e ditës si dhe një përshkrim domethënës të pikave të rendit të ditës; të drejtën për pjesëmarrje dhe dëshmi në mbledhjet e Kuvendit dhe të komiteteve varësisht nga rregullat procedurale në fuqi; të drejtën për qasje në dokumente publike dhe të drejtën për qasje në informata përkitazi me ecurinë e punës, planet, politikat dhe qëndrimet e drejtorateve të ndryshme të Kuvendit të Komunës.

#### **Neni 7**

#### **Informacionet në Internet**

Qeveria e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, në një faqe në rrjetin e internetit ose në ndonjë lokacion tjetër të qasshëm lehtë në internet, do të siguroj informacione të cilat kërkohet që t'i vëhen në dispozicion publikut, duke përfshirë edhe njoftimet me kohë për mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve të tij, si dhe rendet e ditës; procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit dhe të komiteteve të tij; informacionet e kërkuara në pajtim me nenin 6 të kësaj rregulloreje, si dhe kopjet e Statutit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, të Rregullores së Punës dhe të gjitha rregulloreve të tjera të miratuara nga Kuvendi. Çdo drejtorat inkurajohet që t'i vëjë në dispozicion publikut, përmes faqes së vet në internet sa më shumë informacione dhe sa më shumë dokumente që është e mundur lidhur me veprimtaritë e tij. Çdo drejtorat duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të siguruar që faqja në internet të rishikohet për nga saktësia dhe të azhurnohet së paku një herë në muaj.

#### **Neni 8**

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi Komunal.

Kryetari i Kuvendit Komunal  
**Muharrem Shabani**